

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA - Vlada - Government of Kosovo MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEKNOLOGJIE SEKTOR I ARSIMIT - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01B	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	909
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2	Data: Datum Date:	22.02.2018
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologija -- Ministry of Education Science and Technology

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Numër: 262/01B

Datë: 22/02/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 10 paragrafit 1.4 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 / 16 dhjetor 2011, Prishtinë) nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

V E N D I M

Për shfuqizimin e pikës 2 të nenit 2 të Memorandimit të Mirëkuptimit i lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, OJQ Asociacioni "Loyola Gymnazium" dhe Kuvendit të Komunës së Prizrenit dt. 11.10.2004 dhe Aneksit- I- të Memorandimit të Mirëkuptimit me nr. prot. 2890, dt. 02.07.2012.

1. Shfuqizohet pika 2 e nenit 2 të Memorandimit të Mirëkuptimit i lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, OJQ Asociacioni "Loyola Gymnazium" dhe Kuvendit të Komunës së Prizrenit nr. prot. 2890, dt. 02.07.2012.
2. Shfuqizimi i Aneksit- I- të Memorandimit të Mirëkuptimit me nr. prot. 2890 dt. 02.07.2012, i lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe OJQ Asociacioni "Loyola Gymnazium".
3. Shfuqizimi i Memorandimit të Mirëkuptimit dhe Aneksit- I- të Memorandimit të Mirëkuptimit me nr. prot. 2890 dt. 02.07.2012 Asociacioni "Loyola Gymnazium", MASHT nuk ka përgjegjësi për zbatimin e nenit 2 të Memorandimit të Mirëkuptimit i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet në momentin e pranimit të vendimit nga Asociacioni "Loyola Gymnazium".

4. MASHT dhe Gjumnazi "Loyola" në të ardhmen do të shqyrtojnë mundësitë e bashkëpunimit.

5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë si dhe duke pasur parasysh këto fakte si në vijim:

1. Raporti i Auditimit të Zyrës së Auditorit të përgjithshëm me nr. dokumenti 21.4.1-2012-08, maj 2013, i cili ka pamundësuar kryerjen e pagesës të paraparë në pikën 2 të nenit 2 të Memorandumit.

2. Me paragrafin 1.4 të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, janë përcaktuar procedurat e lidhjes së Marrëveshjeve Ndërkombëtare të cilat krijojnë obligime financiare për Republikën e Kosovës. Marrëveshjet Ndërkombëtare të cilat krijojnë obligime financiare për Republikën e Kosovës Ratifikohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe me që kjo marrëveshje krijon obligime financiare për Republikën e Kosovës nuk mund të zbatohet pa Ratifikim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Por, duke pasur parasysh se kjo Marrëveshje nuk është Marrëveshje Ndërkombëtare, nuk mund të dërgohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për Ratifikim.

Asociacioni "Loyola Gymnazium", është shkollë e licencuar nga MASHT dhe është shkollë e Kosovës, prandaj Marrëveshja e tillë nuk mund të procedohet për Ratifikim në Kuvend.

3. Me Udhëzimin administrativ nr. 21/2016 për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria e Subvencioneve dhe transfereve, i cili përcakton procedurën e mbështetjes financiare të personave fizik dhe juridik, si dhe duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se subvencionet janë ndihmë e njëhershme, e cila i jepet personit fizik apo juridik, ndërsa në pikën 2 të nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit është përcaktuar përgjegjësi e MASHT-it për pagesën e pagave të stafit dhe mësimdhënësve në nivel të pagave të mësimdhënësve në shkollat publike, pa e përcaktuar kohëzgjatjen e këtij obligimi, që do të thotë se është plotësisht në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Zyrës së SP;
2. Kabinetit të Ministrit;
3. OJQ Asociacionit "Loyola Gymnazium";
4. Komunës së Prizrenit;
5. Dep. ligjor;
6. Arkivit.



Shyqiri Bytyqi, ministër